

Lënda: Kthim përgjigje

**Z. Luan Kamani**

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me nr. 8726 prot., datë 29.12.2023, për datën e tërheqjes së pensionit mujor nga Zyra Postare A/29-, Tiranë ju informojmë se:

Në marrëveshjen midis ISSH-së dhe Postës Shqiptare sh.a., nr. 3341/ 2038, datë 12.06.2014 “Për transmetimin në format elektronik të përfitimeve të njohura dhe pagesën e këtyre përfitimeve, bazuar në sistemin on line të ISSH-së me Postën Shqiptare sh. a.” – Shtesë në marrëveshjen nr. 4537/1932, datë 21.08.2008, midis ISSH-së dhe Postës Shqiptare sh. a "Për pagimin e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore", ndër të tjera është përcaktuar se:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, është përgjegjëse dhe realizon, hedhjen në Portalin Informatik të Pagesave, të informacionit për përfitimet individuale mujore të caktuara në emër të përfituesit dhe ekspozimit në format elektronik të tyre, nëpërmjet "Mandat Pagesës". Përfitimet mujore të caktuara, pagesat e të cileve janë në vazhdim, mbarten në portalin informatik të pagesave çdo fund muaji – për muajin pasardhës, me kusht që ato të jenë të gatshme për t'u paguar, nga dita e parë e punës e muajit pasardhës.

Pagesat e përfitimeve nëpërmjet Portalit të Pagesave kryhen nga operatorët (punonjësit) e Zyrave Postare në vartësi të Filialeve të Postës Shqiptare, e cila është përgjegjëse për trajnimin e punonjësve dhe për përdorimin e rregullt të sistemit. Rregullshmëria e pagesave, vijueshmëria e tyre ditore dhe pasaktësitë apo gabimet në pagesat e pensioneve janë përgjegjësi e personelit të Postës Shqiptare.

Sa më sipër, vendosja e datës së pagesës së pensionit mujor është kompetencë e personelit të Zyrës Postare, ku ju tërhiqni pensionin.

Faleminderit për mirëkuptimin.